

No. Prot: 292
 Bi. Prot: Prot.No:
 Data: 13.10.2010
 Datum: 10



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë - Ministarstvo Trgovine i Industrije - Ministry of Trade and Industry

Në bazë të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 6 paragrafi 5.2. të Ligjit Nr.03/L-138 Për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit Nr.2004/5 Për tregtinë me naftë dhe derivate të naftës në Kosovë, Ministri i Tregtisë dhe Industrisë nxjerr këtë:

UDHËZIM ADMINISTRATIV Nr. 16/ 2010

PËR CAKTIMIN E LARTËSISË SË TAKSAVE PËR LICENCIMIN E SUBJEKTEVE NGA SEKTORI I NAFTËS DHE DERIVATEVE TË NAFTËS

Neni 1
Qëllimi

Me këtë Udhëzim Administrativ përcaktohet lartësia e taksave të cilat i paguajnë subjektet për aplikim, licencim dhe përtrirje të licencës në sektorin e naftës e që kanë të bëjnë me importin, deponimin, shitjen me shumicë dhe pakicë të naftës dhe derivateve të saj në Kosovë.

Neni 2
Lartësia e taksave

1. Lartësia e taksave për secilin lloj të licencave dhe përtëritjen e tyre përcaktohet si vijon:

Lloji licencës	Shuma
1.1. Licencë për import të naftës dhe benzinës për konsum të përgjithshëm.....	3.000,00 €;
1.2. Licencë për deponim të naftës dhe benzinës për konsum të përgjithshëm.....	1.000,00 €;
1.3. Licencë për shitje me shumicë të naftës dhe derivateve të saj.....	2.000,00 €;
1.4. Licencë për shitje me pakicë të naftës dhe derivateve të saj	1.000,00 €;
1.5. Licencë për import të LPG-së	2.000,00 €;
1.6. Licencë për deponim të LPG-së	1.000,00 €;
1.7. Licencë për shitje me shumicë të LPG-së	1.500,00 €;

1.8. Licencë për shitje me pakicë të LPG-së	500,00 €;
1.9. Licencë për import të vajrave të rënda sipas produktit të caktuar (mazut, solar, bitumen i lëngëzuar).....	2.000,00 €;
1.10. Licencë për shitje me shumicë të vajrave të rënda.....	2.000,00 €;
1.11. Licencë për import të vajrave, sipas produktit të caktuar (lubrifikante, motorike dhe bazike)....	1.000,00 €;
1.12. Licencë për shitje me shumicë të vajrave.....	1.000,00 €;
1.13. Licencë për import të petrolkoksit	1.000,00 €;
1.14. Licencë për transport të naftës dhe derivateve të saj	500,00 €;
1.15. Licencë për import të kerozinës.....	3.000,00 €;
1.16. Licencë për deponim të kerozinës.....	1.000,00 €;
1.17. Licencë për shitje me shumicë të kerozinës.....	2.000,00 €;
1.18. Licencë për import të naftës industriale.....	5.000,00 €;
1.19. Licencë për import të naftës për përpunim të mëtejshëm	5.000,00 €;
1.20. Licencë për import, shitje me shumicë dhe pakicë të bombolave të gazit për amvisni.....	500,00 €;

Neni 3

Lartësia e taksës për përtrirje të licencës

Për përtrirje të licencës (rilicencim) subjektet paguajnë taksën në lartësi prej 50 % të taksës së përcaktuar në nenin 2 të këtij Udhëzimi Administrativ.

Neni 4

1. Subjektet me rastin e parashtrimit të aplikacionit për licencim apo rilicencim (përtrirje të licencës) paguajnë taksën në lartësi prej 50,00 €.

2. Shuma e paguar e taksës për parashtrim të aplikacionit për licencim apo rilicencim sipas paragrafit 1 të këtij neni, i rimburohet aplikuesit në rast të aprovimit të aplikacionit, në mënyrë që kjo shumë llogaritet në taksën e paguar për licencim respektivisht rilicencim.

Neni 5

Subjektet të cilat i nënshtrohen verifikimit të objekteve, pajisjeve dhe personelit se a janë në pajtim me ligjin dhe udhëzimet administrative në fuqi, paguajnë taksën në lartësi prej 100,00 € për verifikimin e kryer.

Neni 6

Pagesa e taksës për marrje të licencës, në lartësinë e përcaktuar sikurse në nenin 2 dhe 3 të këtij Udhëzimi Administrativ, bëhet pas marrjes së vendimit nga ana e Zyrës mbi lëshuarjen e licencës.

Neni 7

1. Taksat e përcaktuara me këtë Udhëzim Administrativ paguhen përmes llogarisë bankare, të shoqëruara me një kopje të fletëpagesës e cila dorëzohet si dëshmi në Zyrën e Licencimit.

2. Të gjitha të hyrat e realizuara nga pagesa e taksave janë të hyra publike dhe derdhen në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Neni 8 Dispozitat shfuqizuese

Me hyrjen në fuqi të këtij Udhëzimi Administrativ, shfuqizohet Udhëzimi Administrativ Nr. 08/ 2010 'Mbi caktimin e lartësisë së taksave për licencimin e subjekteve nga sektori i naftës dhe derivatet e naftës'.

Neni 9 Hyrja në fuqi

Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Ministri i Tregtisë dhe Industrisë, ndërsa do të zbatohet që nga data 01.11.2010.

Prishtinë, 13.10.2010

Ministri i Tregtisë dhe Industrisë
Lutfi ZHARKU

